

VENDIM
Nr.1197, datë 3.12.2009

**PËR SHPALLJEN E KALASË SË TIRANËS “ZONË ARKEOLOGJIKE “A”” DHE
MIRATIMIN E RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË SAJ**

Në mbështetje të neni 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2 të nenit 30 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Kalasë së Tiranës “Zonë arkeologjike “A””, sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Miratimin e rregullores së administrimit të Kalasë së Tiranës “Zonë arkeologjike “A””, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe organet e njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
E ADMINISTRIMIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” TË KALASË SË TIRANËS

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin dhe zonifikimin e zonës arkeologjike “A” të Klasë së Tiranës, mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” (i ndryshuar).

Neni 2
Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A”

Në zonën arkeologjike “A” të Kalasë së Tiranës lejohet:

1. Restaurimi dhe konservimi i mureve rrethuese dhe strukturave të tjera të kalasë, kryerja e sondazheve dhe gërmimeve arkeologjike me synim studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
2. Restaurimi i monumenteve të kulturës që përfshihen brenda kufijve të zonës arkeologjike mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
3. Rikonstruksioni i rrugëve në të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Neni 3

Në studimet urbanistike për qendrën e Tiranës duhet të merret parasysh bonifikimi arkeologjik i Kalasë së Tiranës dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht bazuar në të dhënat e reja arkeologjike si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 5

Kësaj rregulloreje i bashkëlidhet:

1. Harta e zonifikimit me koordinatat përkatëse gjeografike të marra GPS (Garmin 60).

ZONA ARKEOLOGJIKE "A" E KALASË SË TIRANËS

